

UDHËZIM
Nr. 2, datë 11.3.2015

PËR MËNYRËN, FORMAT DHE PROCEDURËN E DËRGIMIT TË TEKSTIT TË AKTEVE TË BOTUESHME NË FLETORËN ZYRTARE, SI DHE FORMATIN E SHKRUAR NË LETËR DHE FORMATIN ELEKTRONIK TË TYRE

Në mbështetje të pikës 5, të nenit 100, të Kushtetutës dhe të pikës 12, të nenit 8, të ligjit nr. 78/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

1. Teksti i akteve të botueshme në Fletorën Zyrtare i dërgohet Qendrës së Botimeve Zyrtare, në formatin e shkruar në letër dhe në formatin elektronik, nga institucionet shtetërore përkatëse, që kanë miratuar aktin në të njëjtën ditë, por, në çdo rast, jo më vonë se afatet e parashikuara në nenin 8, ligjit nr. 78/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare”.

2. Aktet e botueshme publikohen në Fletorën Zyrtare vetëm atëherë kur versioni përfundimtar, në origjinal, i aktit, është nënshkruar nga organi që e ka nxjerrë atë dhe me kërkesën e tij.

3. Akti i dërguar në formë elektronike duhet të jetë në formatin Word dhe duhet të dërgohet përmes postës elektronike zyrtare ose në CD, bashkëlidhur aktit në formë shkresore.

4. Materiali duhet të dërgohet pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare sipas standardit të gjuhës shqipe. Këto standarde duhen zbatuar edhe për dokumentet bashkëlidhur aktit.

5. Institucioni shtetëror, që dërgon aktin e botueshëm, nëse është e mundur, kujdeset që formati elektronik të nënshkruhet elektronikisht, sipas legjislacionit në fuqi.

6. Të dyja formatet kanë vlerë të njëjtë juridike. Në rast mospërputhjeje të formateve, Qendra e Botimeve Zyrtare i kërkon institucionit të konfirmojë përmbajtjen e saktë të aktit të botueshëm dhe, vetëm pas përgjigjes zyrtare të institucionit dërgues, vijon me botimin e aktit.

7. Marrëveshjet ndërkombëtare botohen, krahas gjuhës shqipe, edhe në gjuhën angleze, në rast se janë nënshkruar në këtë gjuhë. Botimi bëhet në të njëjtën faqe, të ndarë në dy kolona, ku secilit nen në gjuhën shqipe i korrespondon neni në gjuhën angleze dhe, në pjesën e fundit të tyre, vendoset data e nënshkrimit të tyre.

8. Ngarkohen Qendra e Botimeve Zyrtare dhe të gjitha institucionet shtetërore, që botojnë akte në Fletorën Zyrtare, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletorën Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama